



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

**Nr. 99, datë 04.09.2020**

### **“PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr. 10, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencioni i qirasë”, Vendimit nr. 11, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”, Vendimit nr. 68, datë 12.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për tre zona të qytetit të Tiranës për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, si dhe bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare), nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej 317147 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) lekë në muaj, do të përballohen nga fondi i përcaktuar nga zëri i bonusit të strehimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**

<b>Nr</b>	<b>Emer</b>	<b>Atësi</b>	<b>Mbiemër</b>	<b>ID</b>	<b>Vlera qe perfitom</b>
1	Haxhire	Hamdi	Senko	F85320122H	12927
2	Lefteri	Sabri	Shollo	G45605091T	15408
3	Hydajete	Ymer	Mançellari	F65117030P	18738
4	Liri	Qemal	Metushi	F35803026E	10705
5	Antuena	Jorgo	Hykollari	J15523080W	15000
6	Blerina	Refat	Xhaferri	H76231061H	18000
7	Razije	Sami	Basha	H05418065R	15000
8	Prendë	Zek	Ndoj	F56201083V	15938
9	Edison	Ramazan	Pjetri	I60314009E	11403
10	Nazif	Gani	Çuka	H20902029R	21104
11	Violeta	Ndue	Gecaj	G65410099M	15436
12	Valbona	Hysen	Kuçi	I25717155K	15000
13	Nadire	Mexhit	Ramçi	E05130017A	15899
14	Esmeralda	Hajdar	Bega	J45812120M	15000
15	Altin	Qazim	Gjoni	H90313062K	19800
16	Fanë	Risto	Nikolla	E00912012W	10341
17	Halit	Imer	Karaj	F0111017O	12962
18	Islam	Imer	Karaj	F40210075Q	16132
19	Drinalda	Daut	Hoxha	I15121058T	10778
20	Lindita	Sabri	Hoxha	I05519003O	18900
21	Ines	Gaqo	Mala	F26028066T	12676
				<b>TOTAL</b>	317147